

SHOQËRIA TREGTARE ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR

“Gold Beton” Sh.p. k

Kavajë – Shqipëri

AKT THEMELIMI

Në Kavajë, sot me datë 11/07/2023 (dymije e njëzetë e tre), dite e Martë, ne shtetasit Shqipëtar me identitetin e mëposhtëm:

z. Ermal Kapidani atësia Besnik , i datëlindjes 19.04.1978, lindur në Kavaje, dhe banues në Kavaje, mbajtës i dokumentit të identifikimit me Nr ID H80419076M tel 069 537 8374

dhe

z. Klajdio Kokoshi atësia Osman, i datëlindjes 15.08.1996, lindur në Kavaje, dhe banues në Kavaje, mbajtës i dokumentit të identifikimit me Nr ID J60815103G tel 069 432 2076

duke u bazuar ne:

- > Vullnetin e lirë, të plotë, të sinqertë, dhe në iniciativën e lirë private,
- > Në Kushtetuten e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi,
- > Në Ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare”,
- > Ne Ligjin Nr.9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar

Vendosëm si me poshtë:

NENI 1

Themelimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar e cila do të mbajë emrin **“Gold Beton” shpk**, emërtim i cili do të jetë i stampuar dhe në vulën e saj.

NENI 2

Selia qëndrore e Shoqërisë **“Gold Beton” sh.p.k** do të jete ne adresën Rr. Egnatia, Bashkia Kavajë, pasuria me nr.2/635, zonë kadastrale 8551

NENI 3

Shoqëria e shtrin aktivitetin e saj tregtar në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë shtetit, në çdo vend të Komunitetit Europian dhe më gjerë. Me Vendim të Asamblese së Ortakëve mund të krijohen ose anulohen (në rast se janë çelur) Seli, Filiale, Agjensi dhe Përfaqësi si në qytete të tjera të Shqipërisë, ashtu dhe jashtë shtetit. Njësitë e tjera Strukturore të Shoqërisë, si Degë apo Përfaqësi qoftë jashtë shtetit krijohen kur diçka të tillë e parashikon dhe lejon edhe legjislacioni i vendeve të huaja, normat e së drejtës ndërkombëtare private, dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

NENI 4

Kapitali Themeltar fillestar i Shoqërisë do të jetë **1.900.000 Lekë** (Njëmilion e nëntëqind mijë lekë), i zotëruar nga ortakët si më poshtë:

Nr ID	Emri/mbiemri ortakut	% që zotëron	Nr kuotave që zotëron
H80419076M	Ermal Besnik Kapidani	50 %	1 kuotë
J60815103G	Klajdio Osman Kokoshi	50 %	1 kuotë

Kapitali Themeltar fillestar i Shoqërisë është **1.900.000 Lekë** (Njëmilion e nëntëqind mijë lekë) i ndarë në 2 (dy) kuota, ku pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre si më poshtë:

1. Ortaku z.Ermal Kapidani ka ofruar një kontribut në para të barabarte me **950.000 lekë** (Nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, zotëruar i 1 (një) kuote, që perben **50%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

2. Ortaku z.Klajdio Kokoshi ka ofruar një kontribut në para të barabarte me **950.000 lekë** (Nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë zotëruar i 1 (një) kuote, që perben **50%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ky kapital është i vlefshëm për regjistrimin e shoqërisë sipas ligjit nr.9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Ortaku ka pavarësi ligjore, organizative, si dhe të drejta pronësie mbi çdo lloj kapitali, mjetesh monetare, si dhe mbi çdo lloj pasurie tjetër të fituar në rrugë të ligjshme. Shoqëria përgjigjet vetëm me Kapitalin e saj.

NENI 5

Kapitali nuk mund të jetë kurrë i përfaqësuar me Letra me vlerë dhe derdhja e Kapitalit themeltar të Shoqërisë, bëhet para kërkeses drejtuar "Qendrës Kombëtare të Biznesit" për njohjen dhe rregjistrimin e saj si Person Juridik.

NENI 6

Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë është **PA AFAT**, duke filluar aktivitetin e saj nga dita e Shpalljes së saj si Person Juridik.

Me Vendim të Asamblesë së Ortakëve kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë mund të ndryshojë, dhe ky Vendim i dërgohet menjëherë për depozitim Qendrës Kombëtare të Biznesit, kompetente për të kryer regjistrimet e nevojshme në Regjistrin e Shoqërive Tregtare.


NENI 7

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj tregtar në përputhje të plotë me Legjislacionin Shqiptar në fuqi si dhe mbi bazën e këtij Akti Themelimi dhe Statuti.

NENI 8

Shoqëria çel Llogari Bankare në monedhë vendi dhe çdo lloj valute, në Banka vendase ose të huaja, private apo shtetërore, me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin financiar të aktivitetit të saj.

Ortakët dhe Administratori i Përgjithshëm i caktuar prej tyre, depozitojnë faksimilet e firmave të tyre origjinale në Bankat ku është çelur llogaria dhe tërheqja e pjesëve të saj bëhet kur dokumenti bankar është firmosur nga njeri Ortak që është caktuar dhe si Administrator i Shoqërisë. Në rastin kur Ortakët kanë caktuar më shumë se një Administrator, i cili është jashtë ortakërisë, çeku bankar dhe çdo likujdim apo pagesë nënshkruhet nga Ortaku që është dhe Administrator i Përgjithshëm i Shoqërisë.



NENI 9

Pjesët e Kapitalit Themeltar, janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie sipas dispozitave të Kodit Civil.

Ortakët kanë të drejtë që të transferojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pjesërisht apo tërësisht Kontributet tyre përfshirë dhe Fondet e Kontributeve në natyrë.

Transferimet e pjesëve të Kapitalit Themeltar, duhet të jenë të vërtetuara me Kontratë Noteriale dhe për një gjë të tillë Ortakët duhet të marrin paraprakisht Vendim me shkrim, i cili i ushtron efektet juridike të tij vetëm në rast se është noterizuar nga një noter i licencuar në Republikën e Shqipërisë. Shoqëria dhe të tretët, duhet të respektojnë këto Transferime sapo tu behen te ditura.

NENI 10

Shoqëria krijohet për të ushtruar aktivitetin e saj tregtar në këto Drejtime:

Investim dhe Menaxhim në fushën e veprimtarisë ndërtimore, për ndërtimin e çdo lloj godine një ose shumëkatëshe civile, industriale, turistike, bujqësore, qendra biznesi, hotele, bar – restorante, duke përfshirë kompletimet dhe instalimet e nevojshme për to.

Prodhim materiale ndërtimi si beton, materiale inerte, llaç, parafabrikate të ndryshme etj.

Ndërtime dhe mirëmbajtje të rrugëve të çdo kategorie, përfshirë autostrada, veshje me asfaltobeton të rrugëve (ndërtim mbishtrëse), sistemim dhe asfaltim sheshesh, ndërtim pista aeroportesh, ndërtime hekurudhore, ndërtime vepra arti rrugore dhe hekurudhore, ndërtime detare sikurse janë ndërtimet portuale, basena punime thellimi në porte dhe zgjerim kalatash etj.

Investim dhe menaxhim për ndërtimin e urave, çeljen dhe përfundimin e rrugëve të reja, të autostradave të komunikacionit urban dhe interurban.

Investim, menaxhim, ndërtime mbrojtëse dhe punime sistemimi kundër gërryerjeve lumore, liqenore, detare të rezervuarëve pellgmbajtës, kryerje punimesh për gërmime dheu me mjete të mekanizuara, hapje tunelesh dhe kryerje punimesh avancimi dhe përforcimi në to, prodhime pilotash dhe elementëve të tjerë betonarme, prodhim guri për skolierat në ndërtimet portuale, punime çimentimi dhe të injektiveve detare, shtrirje kabllosh e tubacionesh nënujore për naftën gazin etj.

Import – Eksport dhe tregtimin me shumicë dhe pakicë të materialeve të gjithllojshëm ndërtimor, të teknologjive dhe mjeteve të mekanizuara për nevojat e ndërtimit, të pajisjeve e materialeve hidrosanitare, elektrike, të ashensoreve, dyerve të blinduara, të prodhimeve prej duralumini e të pjesëve të ndryshme të këmbimit për çdo makineri apo pajisje, si dhe çeljen e reparteve dhe linjave të prodhimit për të brënda dhe jashtë vendit, si vetëm dhe në bashkepunim me shoqëri private dhe të huaja.


Import – Eksport dhe tregtimin me shumicë e pakicë të mallrave të ndryshme industriale artikujve ushqimore, blektorale, bujqësore dhe të çdo lloj malli tjetër të lejuar për tregtim.

Marrjen pjesë në Panaire kombëtare dhe ndërkombëtare, që kanë të bëjnë me çeljen dhe zhvillimin e biznesit, në fushën e ndërtimit dhe të teknologjive bashkëkohore, me qëllim jo vetëm ekspozimin e gamës së prodhimeve ndërtimore të shoqërisë por dhe për të mundësuar arritjen e marrveshjeve kontraktore me persona juridik vendas dhe të huaj, për zgjerimin apo kooperimin në aktivitet tregtar të përbashkët me to, si dhe pjesmarrje në tendera brënda dhe jashtë vendit.

Realizimin e shitblerjeve dhe dhënien me qera të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme.

NENI 11

Me Vendim të Asamblesë së Ortakëve, Shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose më shumë ortak të tjerë, shtetas Shqipëtar apo të huaj, ose të bashkohet me një Shoqëri tjetër tregtare si brenda dhe jashtë vendit.



NENI 12

Asambleja e Ortakëve është Organi më i lartë **Drejtues** dhe **Vendimor** i Shoqërisë. Ajo ushtron të gjitha kompetencat që Ligji “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i njej Asamblese se Ortakëve për shoqëritë me Ortakëri.

Ortakët në mirëkuptim dhe duke vënë paraprakisht në dijeni njëri tjetrin mund t’ja delegojne Kompetencat një ose më shumë Administratorëve të caktuar prej tyre ose dhe një Personi fizik apo Juridik, vendas apo i huaj edhe jashtë ortakërisë së Shoqërisë, mbi bazën e **Prokurës**, të bërë me Akt Noterial.

NENI 13

Administrator i Përgjithshëm i Shoqërisë, caktohet :

z.Klajdio Kokoshi atësia Osman , i datëlindjes 15.08.1996, lindur në Kavaje, dhe banues në Kavaje, mbajtës i dokumentit të identifikimit me Nr. J60815103G.

tel 0694322076, me një afat emerimi **5-vjecar nga data 11/07/2023 deri në datën 11/07/2028**.

NENI 14

Ky AKT Themelimi u redaktua në 5 ekzemplarë me përmbajtje dhe vlerë të njejtë juridike në gjuhën Shqipe dhe është i vlefshëm de jure, kur në të gjithë faqet e tij është vendosur emri, mbiemri dhe firma origjinle e Ortakëve Themelues.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË TREGTARE

ME PËRGGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Gold Beton” shpk

z. Ermal Kapidani

Ermal Kapidani

z. Klajdio Kokoshi

Klajdio Kokoshi